

VENDIM
Nr.56, datë 20.9.2006

**PËR AFATIN E PARAQITJES SË APLIKIMEVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALET E VOGLA**

Në mbështetje të neneve 9, 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e datës 20.9.2006,

VENDOSI:

1. Të gjithë të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet e vogla, duhet të paraqesin aplikimin për rishikimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike, brenda datës 30 shtator të vitit paraardhës të periudhës për të cilën kryhet aplikimi.
 2. Në rast të mosrespektimit të pikës 1 të këtij vendimi, ERE-s i lind e drejta të bëjë rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike.
 3. Aplikimi duhet të paraqitet për një vit kalendarik.
 4. Në kuptim të këtij vendimi, do të përfshihen në kategorinë e centraleve të vogla, centralet me një kapacitet deri në 5 MW, si dhe hidrocentrali i Smokthinës.
 5. Shfuqizimin e vendimit nr.53, datë 26.9.2005.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta